



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 84, datë 30.03.2021

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “BALKGAZ” SH.P.K. PËR MARRJEN E  
AUTORIZIMIT TË ERE-S PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT TË VETËM TË  
SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 13, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe nenit 9, pika 2, të Kushteve të Licencës për Veprimtarinë e Tregtimit të Gazit Natyror, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 24, datë 30.01.2018, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.03.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 39/1 prot., datë 23.03.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Gazit Natyror,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “BALKGAZ” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 433, seria TGN18, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë shoqërisë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 256, datë 17.12.2018.
- Me shkresën e datës 10.02.2021, protokolluar në ERE me nr. 294 prot., datë 10.02.2021, përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “BALKGAZ” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për miratimin e ndryshimit të ortakut të vetëm të shoqërisë “BALKGAZ” sh.p.k.
- Kërkesa e shoqërisë vjen në zbatim të nenit 9, pika 2, të Kushteve të Licencës për Veprimtarinë e Tregtimit të Gazit Natyror, ku përcaktohet se: “Nëse i Licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose aksioneri kryesor/ortaku që kontrollon interesat e të Licencuarit ndryshohet pa autorizim nga ERE, Licenca bëhet e pavlefshme dhe anulohet dhe pasuesi i të Licencuarit do të aplikojë për një Licencë të re sipas “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.
- Duke qenë se me shkresën nr. 294 prot., datë 10.02.2021, është paraqitur vetëm kërkesa e shoqërisë për marrjen e autorizimit të ERE-s për ndryshimin e ortakut të vetëm të saj dhe

arsyet për këtë ndryshim, pa u shoqëruar me dokumentacion, dhe duke qenë se në rastin e Autorizimeve ERE shprehet me vendim direkt u vijua me dërgimin e shkresës nr. 294/1 prot., datë 22.01.2021, nëpërmjet të cilës ka orientuar shoqërinë mbi dokumentacionin e nevojshëm për këtë procedurë.

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me numër 294/2 prot., datë 19.03.2021, është paraqitur i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për marrjen e miratimit nga ana e ERE-s për ndryshimin e ortakut të vetëm të shoqërisë “BALKGAZ” sh.p.k.
- Shoqëria “BALKGAZ” sh.p.k., ka shlyer të gjitha pagesat rregullatore ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s për ndryshimin e ortakut të vetëm të shoqërisë “BALKGAZ” sh.p.k., nga shoqëria HGEN ENERJË LËMËTËD SHËRKËTË, tek z. Laid Saath Wadie Habboush.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftoj palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**